





Albanisch

Qarkullimi Rrugor në Gjermani – Ku duhet të kem kujdes? Rregullat themelore të komunikacionit rrugor





Mirë se erdhët në Gjermani

Ju do të qarkulloni për çdo ditë në rrugët tona, si këmbësorë, çiklistë, bashkëudhëtar në autobuzë ose në tramvaj ose edhe me motoçikletë apo veturë. Për sigurinë tuaj dhe për sigurinë në përgjithësi, në Gjermani, ka rregulla të shumta. Shumë prej tyre sigurisht se i njihni, disa të tjera mund të jenë krejtësisht të reja.

Rregulli më i rëndësishëm është: Të jeni të kujdesshëm dhe të mos e rrezikoni vetën dhe të tjerët.

PËRMBAJTJA



Jeni duke ecur në këmbë 6



Jeni duke qarkulluar me biçikletë 12



Jeni duke qarkulluar me biçikletë,
me motor, motoçikletë me pedale
(skuter), motoçikletë 17



Jeni duke qarkulluar me veturë 19



Jeni duke ecur në këmbë



Në qytete ka trotuare për këmbësorë. **Gjithmonë** përdorni i këto **trotuare**. Rugët janë për automjete dhe biçikleta. Aty ku nuk ka trotuare, ju duhet të ecni në rrugë në pjesën e jashtme të shiritit rrugor.

Jashtë qyteteve ju mund të ecni vetëm në pjesën e majtë të **shiritit rrugor**, sepse ashtu keni mundësi që ta shihni trafikun që vjen përballë më mirë dhe në rast nevojë të reagoni duke u larguar anash. Në grup duhet të ecni njëri pas tjetrit në rresht.

Në muzg ose gjatë natës është mirë që të vishni **rroba me ngjyrë të ndritshme apo ngjyrë reflektuese**.





Në disa raste ka edhe rrugë apo lagje të tëra të dedikuara vetëm për këmbësorët: **Zonat e Këmbësorëve**.

Në zonat me qarkullim të qetë, këmbësorëve u lejohet të përdorin të gjithë rrugën. Aty drejtuesit e automjeteve dhe çiklistët duhet të kenë kujdes të veçantë ndaj këmbësorëve. Disa lojëra të veçanta për fëmijët (p.sh. trotineti) janë të lejuara gjithashtu edhe në rrugë. Por pjesëmarrësit në trafik nuk duhet të pengojnë njëri -tjetrin. Këmbësorët nuk kanë përparësi aty.





Në disa **trotuare** apo edhe në disa zona për këmbësorë lejohet edhe qarkullimi me **biçikleta**. Mirëpo aty duhet të jetë edhe shenja paralajmëruese. Në këto raste përkujdesja reciproke është shumë e rëndësishme.



Trotuari i përbashkët
për Këmbësorë dhe
Biçikleta

Nëse dëshironi ta **kaloni rrugën**, duhet ta bëni atë në mënyrë direkte dhe sa më shpejtë që është e mundur. Duhet të keni kujdes të veçantë ndaj automjeteve dhe biçikletave. Mundësisht të mos kalohet rruga ndërmjet veturave të parkuara.

Kaloni rrugën në ato vende ku kalimi është i sigurtë dhe kur duhet të ecni pak më shumë.

▷ **Semaforë:**

Për këmbësorë ka semaforë të veçantë. Në shumicën e rasteve në udhëkryqe, por ndonjëherë edhe ndërmjet tyre. Në ngjyrë të kuqe gjithmonë duhet të ndaloni. Në ngjyrë të gjelbër mund të ecni. Sido që të jetë duhet të kujdeseni se a po ndalon drejtuesi i veturës apo çiklisti.





Tek semaforët e veçantë për këmbësorë shpesh ka disa **butone të verdha**, të cilat duhet të shtypen që të ndizet ngjyra e gjelbër në semafor. Prisni deri sa të ndizet ngjyra e gjelbër.

▷ **Vendkalimi për këmbësorë/Zebra:**

Edhe këtu mund ta kaloni rrugën në mënyrë të sigurtë. Automjetet duhet të ndalen. Duhet të keni gjithmonë kujdes, tregoni qartë se doni ta kaloni rrugën. **Prisni deri sa të ndalen automjetet** dhe atëherë kaloni rrugën shpejtë.



▷ **Ishulli në mes të rrugës:**

Këtu automjetet nuk duhet të ndalen domosdoshmërisht. Prandaj shikoni saktë a është rruga e lirë dhe vazhdoni deri tek ishulli. **Aty mund të prisni**, në rast se ka komunikacion nga ana e kundërt.





- ▷ **Kujdes** tek kalimi i rrugëve me tramvaje: ato kanë gjithmonë **përparësi**, për shkak se nuk mund të ndalen shpejtë.



Nëse jeni së bashku me fëmijë të vegjël, **mbanjin** **ata për dore**, që të mund të kapërcejnë në rrugën.





Nëse shihni ndonjë automjet me dritë të kaltërt ose me bori sinjalizuese (tatütata) duhet të keni kujdes maksimal dhe mos tentoni të kaloni rrugën në asnjë mënyrë. Në të shumtën e rasteve ato janë automjete të Policisë, të Zjar-rëfikësve apo të **Ndihmës së shpejtë në Urgjencë**.



Autobuzët në Gjermani nuk ndalen me shenjë të dorës. Ata ndalen vetëm në **Stacionet e Autobuzave**. Aty do të gjeni edhe planin e autobuzit me orarin e saktë të tij.



Kini gjithmonë parasysh trafikun dhe mos e hutoni veten tuaj!



Jeni duke qarkulluar me biçikletë

Në përgjithësi vlejnë edhe për çiklistët të njëjtat rregulla të trafikut sikurse për drejtuesit e automjeteve (rregullat e përparësisë, rrugët njëkahëshe, semaforët ...)

► Një biçikletë duhet të ketë dritat, frenat dhe **zilen**.



► Biçikletat drejtohen vetëm nga një person.



Fëmijët e vegjël duhet të sigurohen në **ulëse të veçanta** apo rimorkio speciale.



Me biçikletë duhet të qarkulloni sa më shumë në anën e djathtë, por mbani distancë me **automjetet e parkuara**, sepse mund të ndesheni në ndonjë derë të automjetit e cila hapet papritmas.



Mundësisht mos qarkulloni me biçikletë ngjitur me njëritjetrit.



Nëse dëshironi të ktheheni me biçikletë majtas ose djathas, atëherë duhet të **sinjalizoni me dorën e shtrirë** se në cilën anë dëshironi të ktheheni.



- ▶ Nëse në rrugë nuk mund të shihen shenja të përparësisë së kalimit, atëherë pjesëmarrësi në komunikacion i cili vjen nga ana e djathtë ka përparësi kalimi (**rregulli djathtas para majtas**). Në këto lloj udhëkryqesh me përparësi kalimi nga e djathta para majtas, drejtuesi i automjetit duhet t'i japë përparësi kalimit të çiklistit, i cili vjen nga ana e djathtë.

- ▶ Ekzistojnë edhe rregulla të veçanta për çiklistët, p.sh. **semaforë për çiklistë** ose mundësia që të kalohet një rrugë njëkahëshe edhe nga ana e kundërt.



Tabela plotësuese
"E hapur për
çiklistë"

- ▶ Nëse në një rrugë për çiklistë është vendosur **një tabelë e kaltërt me biçikletë të bardhë**, atëherë duhet të përdoret ajo rrugë. Pa këto shenja mund të qarkullohi edhe në rrugë, por mund të qarkulloni edhe në trotuar.



Rrugët për
Biçiklistë



- ▷ Janë disa rrugë në të cilat mos guxoni në asnjë rast të qarkulloni me biçikletë, p.sh. në autostradë ose në rrugë automobilistike. Edhe trotuarët apo **zonat për këmbësorë** mund të jenë të hapura me shenja të veçanta edhe për çiklistët. Në këto raste çiklistët nuk guxojnë të jenë më të shpejtë se këmbësorët dhe duhet të bëjnë shumë kujdes.
- ▷ Mos qarkulloni me biçikletë nëse keni konsumuar alkohol.
- ▷ Mos përdorni telefonin nëse qarkulloni me biçikletë.
- ▷ Kujdes: Nëse një drejtues i kamionit dëshiron të kthehet djathtas, mund edhe të mos ju shohë. Atëherë qëndroni më mirë **mbrapa kamionit**.





- ▶ Mundësisht përdorni gjatë qarkullimit me biçikletë **helmetën**.

- ▶ Fëmijët lejohen të dalin në rrugë vetëm pas moshës 8 vjeçare, para se të mbushin atë atyre iu lejohet të qarkullojnë me biçikletë vetëm në rrugë për këmbësorë. Fëmijët në Gjermani zakonisht duhet të japin provimin për drejtimin e biçikletës në **klasën e katërt në shkollë fillore**.



- ▶ Nëse nuk mund ta keni parasysh situatën në komunikacion edhe mund të zbrisni nga biçikleta dhe ta shtyni, atëherë vlejnë rregullat për këmbësorë



Jeni duke qarkulluar me biçikletë me motor, motoçikletë me pedale (skuter), motoçikletë

Në Gjermani ka disa lloje të ndryshme të **motoçikletave me dy rrota**, për të cilat vlejnë disa rregulla të ndryshme. Por për të gjitha vlen, **detyrimi për të mbajtur helmetë dhe të keni sigurim**, gjithashtu ekziston edhe mosha minimale për vozitje.



Zakonisht duhet të keni patentë shoferi të veçantë ose një certifikatë. Nëse keni patentë shoferi ndërkombëtare apo të huaj, duhet të informoheni për sa kohë vlen ajo në Gjermani dhe cilat motoçikleta mund të drejtoni me të.



Zakonisht mund të drejtohen të gjitha motoçikletat me dy rrota në rrugë. Vetëm motoçikletat të cilat shpejtësinë maksimale e kanë 25 Km/h mund të drejtohen jashtë qyteteve dhe nëse ka shenja të veçanta edhe në trotuar.

Me biçikleta me motor, motoçikletë me pedale (skuter) dhe motor nuk mund të tejkaloni në komunikacion.

Motoçikletat mund të drejtohen **maksimalisht nga 2 Persona**. Mos merrni fëmijë me vete në motoçikletë.



Mos drejtoni motoçikletë, nëse keni konsumuar alko-hol.



Jeni duke drejtuar veturën

Ai, i cili dëshiron ta drejtojë veturën në Gjermani, duhet të ketë patentë shoferi të vlefshme. Nëse keni patentë shoferi ndërkombëtare apo të huaj, duhet të informoheni, se për sa kohë është e vlefshme. Një automjet duhet të jetë i siguruar gjithmonë. Nëse huazoni veturën e një shoku apo një të afërmi, kontrolloni gjithmonë a ekziston sigurimi edhe për ju si drejtues.

- ▷ Të gjithë bashkëudhëtarët në veturë **duhet të vendosin Rripin e Sigurisë**, edhe ata në ulëset mbrapa.





- ▷ Të gjithë fëmijët nën moshën 12 vjeçare, si dhe ata që janë më të vegjël se 150 cm, duhet të sigurohen në **ulëse të veçanta** për fëmijë.
- ▷ Mos telefononi me celular në dorë, mos shkruani mesazhe dhe mos përdorni smartfonin gjatë drejtimit.
- ▷ Mos e drejtoni veturën nëse keni konsumuar alkohol.
- ▷ Për rrugë të ndryshme ka kufizime të **shpejtësisë maksimale** të cilën mund ta drejtoni. Në **varësi të gjendjes së rrugës dhe motit**, duhet të udhëtoni edhe më ngadalë e në mënyrë më të sigurtë.



Nëse jeni i përfshirë në ndonjë aksident, telefononi menjëherë **shërbimin e shpëtimit** në numrin 112. Qëndroni në vendin e aksidentit deri sa të arrijë **policia**.



E kugja do të thotë **Ndal-Stop!**. Për këtë arsye mos kaloni asnjëherë një semafor me ngjyrë të kuqe apo një shenjë Stopi të kuqe





... në qytet.

Në qytet duhet të keni kujdes të veçantë. Aty ka këmbësorë, çiklistë, autobuzë, kamionë dhe në disa raste edhe tramvaje, shumë udhëkryqe dhe semaforë.



Në Gjermani ka shenja komunikacioni, që tregojnë kur hyni dhe dilni nga **zona e vendbanimit**.

Në vendbanime lejohet shpejtësia **maksimale 50 km/h**. Por në disa zona vendbanimi shpejtësia maksimale e lejuar është me më e vogël se **30 km/h**. Kjo vlen për zona të tëra. Përndryshe në qytete mund të jenë të gjitha kufizimet e mundshme 10km/h, 20km/h, 30km/h, 40km/h Pra gjithmonë përcillni shenjat e komunikacionit



Shpejtësia
maksimale
e lejuar



Fillimi i një Zone
me Shpejtësi 30



Në rast kthimi djathtas dhe majtas duhet të keni kujdes të shtuar, nëse ktheheni në vende duhet të lejoni të kalojnë më parë **këmbësorët dhe çiklistët, të cilët janë duke lëvizur përpara**, ata kanë gjithmonë përparësi.

Edhe brenda qytetit ju duhet të vendosni rripin e sigurisë dhe të siguronit posaçërisht fëmijët tuaj.



... në rrugë magjistrale.



Jashtë zonës së vendbanimit në rrugë magjistrale nuk lejohet shpejtësi më e madhe se 100km/h, madje shpesh herë shpejtësia duhet të jetë edhe më e vogël. Kjo është rregulluar dhe shenjuar përmes shenjave përkatëse të komunikacionit.

Kujdes gjatë tejkalimit në rrugë magjistrale: Shpesh herë nuk ka dukshmëri të mirë. Për këtë arsye duhet të jeni të kujdesshëm gjatë drejtimit. Nëse shihni shenjën e cila e **ndalon tejkalimin**, atëherë kurrësi mos tejkaloni! E njëjta gjë vlen edhe në zonat ku ndodhet vija e plotë!



Ndalim tejkalimi

Kujdes trafikun e përballë kalimit në rast të kthimit majtas!



... në autostradë.

Këtu zakonisht ekzistojnë së paku dy korsi për lëvizje në një drejtim. **Shpejtësia maksimale** e lejuar është **130 km/h**.

Por, shpesh herë ekzistojnë edhe kufizime të tjera të cilat janë të paraqitura me shenja të trafikut.

Edhe në autostradë ju duhet të qarkulloni në anën e djathtë. Në rast të tejkallimit ju duhet të tejkaloni veturat të cilat lëvizin me shpejtësi më të vogël. Ndalohet tejkalimi në anën e djathtë, kthimi mprapa dhe kthesa.

Vetëm në rastet emergjente ose aksidenti-avari lejohet ndalimi në shiritin ndihmës të autostradës.





Në këto raste duhet të përdoren gjithmonë jelekët paralajmëruese, të cilat duhet të gjinden në çdo veturë, përndryshe kjo gjë është e ndaluar. Nëse dëshironi të pushoni kërkoni vendin e pushimit. Shfrytëzoni hyrje - daljet e autostradës për tu kyqur apo për tu shkyqur nga autostrada.

Asnjëherë mos qarkulloni në këmbë në autostradë!



Informata të tjera:

www.germanroadsafety.de



Në këtë faqe të Internetit ju do të mund të shkarkoni këtë broshurë në gjuhë tjera. Shkarkimi është pa pagesë.



INFORMATA RRETH NESH

Publikuar nga:



Unfallforschung der Versicherer (UDV)
(Hulumtimet e aksidenteve të të siguruarve)
Wilhelmstraße 43/43 G, 10117 Berlin
Postfach 08 02 64, 10002 Berlin
www.udv.de, www.gdv.de



Deutsche Verkehrswacht e.V.
(Asociacioni Gjerman i Mbikëqyrjes dhe sigurisë së trafikut)
Budapester Straße 31, 10787 Berlin
www.deutsche-verkehrswacht.de



Deutscher Verkehrssicherheitsrat (DVR)
(Këshilli Gjerman i Sigurisë rrugore)
German Road Safety Council
Auguststraße 29, 53229 Bonn
www.dvr.de

Redaksia: Klaus Brandenstein (UDV - Hulumtimet e aksidenteve të të siguruarve), Jörg Ortlepp (UDV), Kay Schulte (DVR - Këshilli Gjerman i Sigurisë rrugore), Daniel Schüle (DVR - Asociacioni Gjerman i Mbikëqyrjes dhe sigurisë së trafikut)

Koncepti + dhe dizajni: pensiero KG, www.pensiero.eu

Burime të fotografive:

Kopertina: RedDaxLuma - fotolia.com, Fq. 6: Heiko Küverlin - iStock.;
Fq.7: Michael Luhnberg - iStock.; Fq. 8 (unten): Thomas Stefan Wagner;
Fq.9 (oben): villy_yovcheva - iStock.; Fq. 10 (oben): Terry J. Alcorn - iStock.;
Fq. 10 (unten): lisovoy - fotolia.com; Fq. 11 (oben): k_ rahn - fotolia.com;
Fq. 11 (mitte): Vera Stadler; Fq. 13 (oben): Avanne Troar - fotolia.com;
Fq. 14: kara - fotolia.com; Fq. 16 (oben): mma23 - fotolia.com; Fq. 17: Marjot - iStock.;
Fq. 18 (oben): Vera Stadler; Fq. 18 (unten): RRF - fotolia.com; Fq. 19: Susan Chiang - fotolia.com;
Fq. 20: Gina Sanders - fotolia.com; Fq. 21 (oben + unten): Christian Müller - fotolia.com;
Fq. 22: Karl-Heinz Wagner; Fq. 24: GAP artwork - fotolia.com; Të drejtat e shfrytëzimit të fotografive të shfaqura në këtë broshurë janë për hulumtime të aksidenteve të personave të siguar përkatësisht në Këshillin e Sigurisë rrugore në Gjermani

Botimi në gjuhën shqipe

Këtë Broshurë mund ta gjeni edhe
në gjuhë të tjera pa pagesë.

Shkarko këtu:

www.germanroadsafety.de

